

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

# Raportimi financiar

# P5

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 03.07.2021

1. Addo sh.a bleu 80% të aksioneve të zakonshme të Manu sh.a me 1 prill 2020. Konsiderata e blerjes ishte €51,400,000 në para. Pasqyrat financiare të të dy kompanive janë paraqitur më poshtë:

**Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020**

	<b>Addo sh.a</b>	<b>Manu sh.a</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat nga shitja	300,000	120,000
Kosto e shitjes	<u>(210,000)</u>	<u>(100,000)</u>
Fitimi bruto	90,000	20,000
Kosto e shpërndarjes	(20,000)	(800)
Shpenzimet administrative	(10,000)	(200)
Kosto Financiare	<u>-</u>	<u>(1,000)</u>
Fitimi para tatimit	60,000	18,000
Tatimi në fitim	<u>(15,000)</u>	<u>(3,000)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>45,000</b>	<b>15,000</b>

**Pasqyra e pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020**

	<b>Addo sh.a</b>	<b>Manu sh.a</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	96,600	40,000
Investimet	<u>56,400</u>	<u>10,000</u>
	153,000	50,000
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	35,000	15,000
Të arkëtueshmet tregtare	25,000	13,000
Banka	<u>15,000</u>	<u>12,000</u>
	<u>75,000</u>	<u>40,000</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>228,000</b>	<b>90,000</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	50,000	10,000
Fitimet e mbajtura	<u>128,000</u>	<u>42,000</u>
	178,000	52,000
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
10% Notë kreditore	-	10,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>		
Te pagueshmet tregtare	<u>50,000</u>	<u>28,000</u>
	<u>50,000</u>	<u>28,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>228,000</b>	<b>90,000</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- (i) Fitimet e mbajtura të Manu sh.a-së me 1 janar 2020 ishin €27,000,000.
- (ii) Vlera e drejtë e pasurive neto të Manu sh.a-së ishte e barabartë me vlerën e saj bartëse në datën e blerjes me përjashtim të një prone e cila kishte vlerë të drejtë prej €16,000,000 mbi vlerën bartëse. Prona kishte jetë të mbetur të pëtdorimit prej 4 viteve në atë datë dhe zhvlerësimi ngarkohet në baza drejtvizore dhe përfshihet në kosto të shitjes. Manu sh.a nuk i ka inkorporuar korigjimet e vlerës së drejtë në pasqyrat e saj financiare.
- (iii) Në periudhën pas blerjes Addo sh.a shiti mallra tek Manu sh.a. Këto mallra i kishin Addo sh.a-së €45,000,000 dhe marzha e fitimit në çmimin e shitjes (jo në kosto) të Addo sh.a-së ishte 25%. Manu sh.a kishte ende mallra të blerë nga Addo sha në stoqe në vlerë prej €10,000,000 me 31 dhjetor 2020.
- (iv) Manu sh.a i kishte borxh Addo. sh.a-së lidhur me blerjen e mallrave një shumë prej €5,000,000 të cilën e kishte paguar me 29 dhjetor 2020 mirëpo Addo sh.a ende nuk e kishte pranuar dhe regjistruar pagesën deri me 31 dhjetor 2020. Manu sh.a e ka regjistruar pagesën në pasqyrat financiare.
- (v) Zëri i mirë është dëmtuar dhe një humbje nga dëmtimi prej €1,500,000 duhet të njihet në fund të periudhës raportuese. Dëmtimi i zërit të mirë ngarkohet tek shpenzimet administrative.
- (vi) Addo sh.a kishte blerë 1% të aksioneve të Donana sh.a me 1 janar 2020 për një konsiderate prej €5,000,000 dhe këto aksione mbahen për tregtim. Vlera e drejtë e aksioneve me 31 dhjetor 2020 ishte €4,000,000. Addo sha nuk kishte bërë ende asnjë korigjin të vlerës së aksioneve. Manu sh.a gjatë vitit kishte blerë 2% të aksioneve në Garajonay sh.a në shumë prej €10,000,000 të cilat i mban për tregtim dhe nuk kishte ndryshim në vlerën e drejtë në datën e raportimit.
- (vii) Është politike e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë. Në atë datë, aksionet e Manu sh.a-së kishin një çmim prej €6.25 dhe kjo paraqet vlerën e drejtë të aksioneve që mbahen nga interesi jo-kontrollues.
- (viii) Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet ndodhin një trajtësisht gjatë vitit.
- (ix) Asnjera kompani nuk ka paguar dividendë gjatë vitit.

**Kërkohet:**

- (a) **Përgatite Pasqyrën e Konsoliduar të Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**
- (b) **Përgatite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**

(a)

**Pasqyra e Konsoliduar të Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020**

	€'000
Të hyrat nga shitja $300,000 + (120,000 \times 9/12) - 60,000$ L12	330,000
Kosto e shitjes $210,000 + (100,000 \times 9/12) - 60,000$ L12 +2,500 L12 +3,000 L13	<u>(230,500)</u>
Fitimi bruto	99,500
Kosto e shpërndarjes $20,000 + (800 \times 9/12)$	(20,600)
Shpenzimet administrative $10,000 + (200 \times 9/12) + 1,500$ L11	(11,650)
Humbja nga rënia në vlerë e aksioneve	(1,000)
Kosto financiare	<u>(750)</u>
Fitimi para tatimit	65,500
Tatimi në fitim $15,000 + (3,000 \times 9/12)$	<u>(17,250)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>48,250</b>
Fitimi për vitin i atribuar prindit (shifer balancuese)	46,900
Fitimi për vitin i atribuar IJK-së L1 4	<u>1,350</u>
	<b>49,250</b>

**(b) Pasqyra e Konsoliduar të Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020**

<b>Pasuritë</b>	<b>€'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
PPF $(96,600 + 40,000 + 16,000 - 3,000)$ L13)	149,600
Investimet $(5,000 + 10,000 - 1,000)$	14,000
Zëri i mirë (L11)	<u>5,650</u>
	169,250
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet $(35,000 + 15,000 - 2,500)$ L12)	47,500
Të arkëtueshmet tregtare $(25,000 + 13,000 - 5,000)$ ndërgrupor)	33,000
Banka $(15,000 + 12,000 + 5,000)$ ne tranzit)	<u>32,000</u>
	<u>112,500</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>281,750</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar 50,000	50,000
Fitimet e mbajtura L14	129,900
IJK (L15)	<u>13,850</u>
	193,750
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
10% Notë kreditore	10,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Te pagueshmet tregtare $(50,000 + 28,000)$	<u>78,000</u>
	<u>88,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>281,750</b>

**L11 Struktura e grupit dhe zëri i mirë Addo sh.a: 80% IJK: 20%**

<b>Zëri i mirë</b>		<b>€'000</b>
Konsiderata e blerjes		51,400
VD e IJK-së $10,000 \times 20\% \times €6.25$		<u>12,500</u>
		63,900
<u>Minus VD e PN</u>		
Aksionet e zakonshme	10,000	
Fitimet e mbajtura	30,750	
Vlera e drejtë e Pronës	16,000	
		<u>(56,750)</u>
Zëri i mirë në blerje		7,150
Minus dëmtimi		<u>(1,500)</u>
<b>Zëri i mirë në datën e raportimit</b>		<b>5,650</b>

Fitimet në datën e blerjes

1 janar 2020 (€27,000,000) + nga 1 janar 2020 deri me 1 prill 2020 ( $15,000,000 / 12 \times 3$ ) =  
= €27,000,000 + €3,750,000 = €30,750,000

**L12 Shitjet ndërgrupore**

Addo shiti	
Kosto	45,000
Fitimi bruto $45,000 \times 25/75$	<u>15,000</u>
Shitja	60,000
Fitimi i porealizuar $15,000 \times 10,000/60,000 = 2,500$	

**L13 Zhvlerësimi shtesë**

Zhvlerësimi shtesë =  $16,000/4 = 4,000 \times 9/12 = 3,000$   
PFP:  $16,000 - 3,000 = 13,000$  korigjim

**L1 4 Fitimet e mbajtura**

	<b>Addo sh.a</b>	<b>Manu sh.a</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Sipas detyres	128,000	42,000
Para blerjes		<u>(30,750)</u>
Pas blerjes		11,250
Dëmtimi i ZM L11		(1,500)
Zhvlerësimi shtesë L13		<u>(3,000)</u>
FPR (L12)	(2,500)	
Humbja nga rënia në vlerë e aksioneve	(1,000)	
		6,750
Pjesa e degës që i takon prindit ( $6,750 \times 80\%$ )	<u>5,400</u>	
	<b>129,900</b>	

<b>L1 5 IJK</b>	<b>€'000</b>
IJK në fillim	12,500
Fitimet gjate vitit ( $6,750 \times 20\%$ )	<u>1,350</u>
<b>IJK në fund</b>	<b>13,850</b>

2. Vanoise sh.a, një kompani e listuar në bursë mirret me përpunim kimik përgatiti këtë draft pasqyrë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020.

<b>Vanoise sh.a</b>		
<b>Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020</b>		
	€'000	€'000
<i>Pauritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika & paisjet		1,020,000
Pronat investuese		100,000
Investimet në ekuitet		<u>360,000</u>
		1,480,000
<i>Pauritë qarkulluese</i>		
Stoqet		65,000
Të arkëtueshmet tregtare		100,000
Paraja		<u>60,000</u>
		<u>225,000</u>
<b>Total pasuritë</b>		<b>1,705,000</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar dhe premia e aksioneve		580,000
Fitimet e mbajtura: saldo 1 janar 2020	375,000	
Fitimi i vitit	95,000	
Dividena e deklaruar	<u>(30,000)</u>	
		440,000
Rezervat tjera: saldo 1 janar 2020	128,000	
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	<u>35,000</u>	
		1,183,000
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Dëtyrimet ndaj lizingut	175,000	
5% Notë kreditore 2025	<u>150,000</u>	
		325,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare		95,000
Detyrimet ndaj lizingut		35,000
Provizionet për garancione		12,000
Tatimi aktual		25,000
Dividenda e pagueshme		<u>30,000</u>
		197,000
<b>Total ekuieti dhe detyrimet</b>		<b>1,705,000</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- (i) Prona, fabrika dhe pajisjet barten pas ngarkimit të zhvlerësimit për vitin. Më 31 dhjetor 2020, një pjesë e pronës, e bartur në €100 milion, u rivlerësua në €80 milion. Ky rivlerësim nuk është kontabilizuar. Rezerva e rivlerësimit (e përfshirë në rezervat tjera) kishte një saldo prej €12 milion për shkak të rivlerësimeve të mëparshme të kësaj pasurie.

- (ii) Investimet në ekuitet kishin një vlerë të drejtë prej €380 milion në 31 dhjetor 2020, e cila ende nuk është përfshirë në pasqyrat financiare. Vanoise sh.a ka marrë një vendim që të dergoj të gjitha përfitimet dhe humbjet në vlerë të drejtë në investimet e ekuitetit në "të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse" siç lejohet nga SNRF 9 *Instrumentet Financiare*
- (iii) Kompania shiti fabrikën në 5 dhjetor 2020. Fabrika e shitur kishte një vlerë bartëse prej €45 milion në datën e shitjes, ajo ishte shitur për një çmim të dakorduar prej €39 milion. Asnjë para nuk është marrë ende në lidhje me këtë shitje, pasi njëafat pagese prej 44 ditësh ishte rënë dakord me blerësin. Asnjë hyrje nuk është bërë për të regjistruar këtë transaksion.
- (iv) Vanoise sh.a kontabilizon pronat investuese me vlerën e drejtë, siç lejohet nga SNK 40 *Pronat Investuese*. Një vlerësues i kualifikuar profesionalisht vlerësoi pronat investuese në fund të vitit 2020 në €200 milion. Asnjë hyrje nuk është bërë në këtë shifër në libra që nga fundi i vitit paraprak.
- (v) Notat e kredisë prej 5% u emetuan me 1 janar 2020 dhe të ardhura në para prej 150 €milion ishin regjistruar në mënyrë korrekte. Kushtet e ripagimit të këtyre notave të kredisë janë të tilla që norma efektive e interesit deri në maturim ishte 6.5%. E vetmja hyrje tjetër e bërë në lidhje me notat e kredisë ishte pagesa e interesit prej €7.5 milion në datën e datës 31 dhjetor 2020.
- (vi) Vlera neto e realizueshme e stokeve në fund ishte €66 milion, dhe nuk janë bërë korigjime. Shuma e stokeve në pasqyrën e pozitës financiare paraqet koston.
- (vii) Vanoise sh.a ofron një garanci 12-mujore për të gjitha mallrat e shitura tek klientët me pakicë. Regjistrohet një provizion për koston e pritur të respektimit të kësaj garancie. Kjo nuk është azhurnuar më 31 dhjetor 2020. Vanoise sh.a shiti 40,000 njësi të produktit të saj përkatës gjatë vitit, të gjitha këto kualifikohen për garanci. Vanoise sh.a pret që 10% e këtyre do të kishin nevojë për riparime të vogla me një kosto mesatare prej €500 secila, dhe 6% do të kishin nevojë për riparime të mëdha me një kosto prej €5,000 secila. Të gjitha kostot pritet të ndoshin brenda 12 muajve.
- (viii) Gjatë vitit deri në 31 dhjetor 2020 kompania bëri një emetim të të drejtave prej një aksioni për çdo pesë aksione me një çmim prej €2.25 për aksion. Të drejtat u shfrytëzuan plotësisht dhe janë kontabilizuar saktë në kapitalin aksionar dhe premia e aksioneve.

**Kërkohet:**

- (a) **Përgatitni një tabelë që tregon çdo korigjim të kërkuar në pasqyrën e Fitim ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020. (8 pikë)**
- (b) **Riparaqite Pasqyrën e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020 duke marrë parasysh informatat më sipër. (12 pikë)**

**(total 20 pikë)**

**Vanoise sh.a**

a) Tabela e korigjimeve të kërkuara në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon me 31 dhjetor

	Fitimi për vitin	TTGJ për vitin
	€'000	€'000
Shumat sipas draft pasqyrave financiare	95,000	35,000
Përfitimi nga vlera e drejtë e pronës investuese L15	100,000	
Rivlerësimi i pronës L11	(8,000)	(12,000)
Humbja nga shitja e fabrikës L11	(6,000)	
Përfitimi nga vlera e drejtë e instrumenteve të ekuitetit L12		20,000
Kosto financiare shtesë L13	(2,250)	
Provizion shtesë për garancion L14	(2,000)	-
<b>Shumat e korigjuara</b>	<b>176,750</b>	<b>43,000</b>

b)

**Vanoise sh.a**

**Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020**

	€'000	€'000
<i>Pauritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika & paisjet (1,020,020 -45,000L11-20,000L11)		955,000
Pronat investuese		200,000
Investimet në ekuitet (360,000+20,000 L12)		<u>380,000</u>
		1,535,000
<i>Pauritë qarkulluese</i>		
Stoqet		65,000
Të arkëtueshmet tregtare (100,000+39,000 L11)		139,000
Paraja		<u>60,000</u>
		<u>264,000</u>
		<b>1,799,000</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar dhe premia e aksioneve	580,000	
Fitimet e mbajtura: saldo 1 janar 2020	375,000	
Fitimi i vitit	176,750	
Dividena e deklaruar	<u>(30,000)</u>	
		521,750
Rezervat tjera: saldo 1 janar 2020	128,000	
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	<u>43,000</u>	
		<u>171,000</u>
		1,272,750
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Dëtyrimet ndaj lizingut	175,000	
5% Notë kreditore 2025 (150,000+2,250 L13)	<u>152,250</u>	
		327,250
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare		95,000
Detyrimet ndaj lizingut		35,000
Provizionet për garancione (12,000+2,000 L14)		14,000
Tatimi aktual		25,000
Dividenda e pagueshme		<u>30,000</u>
		<u>199,000</u>
<b>Total ekuieti dhe detyrimet</b>		<b>1,799,000</b>



### **Logaritjet:**

#### **L11 - Prona, Fabrika dhe paisjet**

Kjo pjesë e pronës duhet të rivlerësohet në rënie për €20 milion (100-80). Një rivlerësim në rënie në një pasuri të SNK 16 *Pronat, Fabrika dhe Pajisjet* duhet t'i ngarkohet rezervës së rivlerësimit (dhe TTGJ) në masën që ekziston një saldo në atë rezervë në lidhje me të njëjten pasuri. Këtu, kjo shumë është €12 milion. Çdo humbje e mëtejshme e rivlerësimit duhet të regjistrohet në fitim ose humbje. €8 milion shtesë e humbjes duhet të ngarkohet në F/H.

Fabrika duhet të çregjistrohet. Prandaj, një humbje nga largimi në vlerë prej €6 milion (39-45) do të regjistrohet në fitim ose humbje. €45 milion do të çregjistrohen nga PPE, dhe një e arkëtueshme prej €39 milion regjistruar në pasuritë qarkulluese pasi që ajo ishte shitur për një afat pagese prej 44 ditësh.

#### **L12 - Investimet në ekuitet**

Sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare*, investimet në ekuitet duhet të klasifikohen si instrumente financiarë "Vlera e drejtë" dhe të ri-maten në vlerën e drejtë në çdo datë raportimi. Çdo fitim ose humbje që rezulton, ngarkohet në fitim ose humbje përveç nëse kompania bën një zgjedhje të përvokueshme për t'i paraqitur ato në TTGJ. Vendimi është marrë nga Vanoise sh.a, prandaj përfitimi në vlerë prej €20 milion (380 - 360) duhet të dergohet në TTGJ, si dhe të pasqyrohet në vlerën kontabël të investimeve të ekuitetit.

#### **L13 - Notat e kredisë**

Sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare* metoda e kostos së amortizuar është e përshtatshme për këtë detyrim pasi nuk ka prova që sugjerojnë se kompania po e trajton detyrimin si një instrument të tregtueshëm. Prandaj, shpenzimi vjetor i financimit duhet të pasqyrojë normën efektive deri në maturim e jo normën e kuponit. Kostoja e saktë financiare duhet të jetë €150 milion  $\times 6,5\% = €9,75$  milion në vend të asaj të regjistruar €7,5 milion. €2.25 milion shtesë (9.75 - 7.5) duhet të ngarkohet si një kosto financiare në fitimin ose humbjen dhe të përlllogaritet si një detyrim afatshkurtër shtesë.

#### **L14 - Provizionet për garancione**

Detyrimi aktual për dhënien e garancisë duhet të azhurnohet në çdo datë raportimi për të pasqyruar vlerësimet më të mira të disponueshme në atë datë. Në 31 dhjetor 2020 vlerësimet më të mira sugjerojnë se kërkohet një provizion prej €14 milion, llogaritur si më poshtë:

	€
Riparime të vogla: (4,000 $\times$ €500)	2 milion
Riparime të mëdha: (2,400 $\times$ €50,000)	12 milion

Ndërsa provizioni ekzistues është regjistruar në €12 milion, duhet të bëhet një rritje shtesë prej €2 milion për ta rritur provizionin në €14 milion të kërkuara. Kjo duhet të ngarkohet në fitim ose humbje, dhe t'i shtohet provizionit ekzistues.

#### **L15 - Pronat investuese**

Sipas SNK 40, përfitimet e vlerës së drejtë duhet të raportohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe prona investuese të jetë me vlerë të drejtë e rriturr për €100 milion. Prandaj debitori pronen investuese dhe fitimin ose humbjen / fitimet e mbajtura me €100 milion.

#### **L16 - Stoqet**

Sipas SNK 2, stoqet, nuk kanë nevojë për rregullim. Stoqet maten me më të ulëtën prej kostor dhe VNR.

#### **L17 - Emetimi i të drejtave**

Asnjë rregullim nuk është i nevojshëm pasi që është llogaritur saktë.

3.

a) Fitimi pas tatimit për Gran Paradiso sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 ishte €15 milion. Me 1 janar 2020 Gran Paradiso sh.a kishte në emetim 36 milion aksione të zakonshme dhe një notë krediti të konvertueshme prej €10 milion me norme të interesit prej 8%. Nota e kreditit do të maturoj në vitin 2022 dhe do të paguhet në të njëjtën shumë ose do të konvertohet në aksione të zakonshme në bazë të 25 aksioneve për çdo €100 notës kreditore në opsjon të mbajtësve të notës kreditore. Më 1 prill 2020 Gran Paradiso sh.a bëri një emetim të drejtave të ushtruara plotësisht të një aksioni të ri për çdo katër aksione të mbajtura me një çmim prej €2.80 secila. Çmimi i tregut i aksioneve të zakonshme të Gran Paradiso sh.a menjëherë para emetimit ishte €3.80. Fitimet për aksion (FPA) të raportuara për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 ishin 35 cent. Norma e tatimit mbi është 25%.

**Kërkohet:**

**Llogarite fitimin themelor për aksion për për Gran Paradiso sh.a (përfshirë informatën krahasuese) the fitimin e dobësuar për aksion (informata krahasuese nuk kërkohet) që duhet të shpalosen për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**

b) Me 1 janar 2020 Abisko sh.a fitoi dy kontrata ndërtimi për dy ndërtesa. Abisko sh.a është e specializuar në ndërtimin e ndërtesave të zyrave për klientë të ndryshëm dhe ka një politikë të matjes së përmbushjes së obligimeve për performancë duke u bazuar në punën certifikuar si përqindje e çmimit të kontratës e cila është dhënë më poshtë. Detajet e mëposhtme kanë të bëjnë me të dy ndërtesat në 31 dhjetor 2020;

	<b>Ndërtesa 1</b>	<b>Ndërtesa 2</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Vlera e kontratës	200	160
Kosto deri me datë	80	150
Kosto e vlerësuar deri në përfundim	60	50
Shumat e faturuara	31.2	134
<b>Data e fillimi</b>	<b>1 janar 2020</b>	<b>1 mars 2020</b>
<b>% e përfundimit</b>	<b>45%</b>	<b>80%</b>

**Kërkohet:**

**Tregoni se si secila kontratë dihet të paraqitet në passqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes të Abisko sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.**

**(10 pikë)**

### 3.

#### a)

çmimi teorik i ish të drejtave:

4 aksione me €3.80 =15.2

1 aksione me €2.80 =2.8

18.0 / 5 = €3.60

Llogaritja e mesatares se peshuar:

1 janar 2020  $36 \times 3/12 \times €3.80/€3.60 = 9.5$

1 prill 2020 Emetimi i të drejtave  $45 \times 9/12 = \underline{33.75}$   
43.25

FPA themelore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 është:

€15m/43.25m = 34.7cent

FPA themelore krahasuese = 35 cent  $\times 3.6/3.8 = 33.2$  cent

*Ne menyre alternative:*

*Llogaritja*

Aksionet e emetuara sipas te drejtave = 9 mil

Arketimi 25.2 milion (9 milion  $\times$  2.8)

Nr i aksiove te emetuara ne para

7.00 (25.2 milion /€3.6)

Nr I aksioneve te emetuara bonus

2.00 (diferenca 9-7)

1 janar	36 mil	36.00	$\times 12/12$	36
1 prill	emetim bonus	2.00	$\times 12/12$	2
1 prill	emetim ne para	7.00	$\times 9/12$	<u>5.25</u>
				43.25

FPA e dobësuar:

Fitimi do të rritet për €800,000 (€10m  $\times$  8%) minus 25% tatim = €600,000

Aksionet shtese do të rriten për (10m/100)  $\times$  25 = 2.5m

Efekti neto do të jete €600,000/2.5m = 24 cent. Pasi qe është më pak se FPA themelore është dobesues.

Fitimet = €15.6m

Aksionet = 43.25 + 2.5 = 45.75

FPA e dobësuar = 34.1 cent

#### b)

Ndërtesa 1; Kontratë me fitim (200- 80- 60) €60,000

Ndërtesa 2; Kontrate me humbje (160 -150 -50) (€40, 000)

*Pasqyra e fitimit ose humbjes – ekstraktet*

	<b>Ndërtesa 1</b>	<b>Ndërtesa 2</b>	<b>Total</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat	90	128	218
Kosto e shitjes	<u>(63)</u>	<u>(168)</u>	<u>(231)</u>
Fitimi / (humbja) e njohur	27	(40)	(13)

*Pasqyra e pozitës financiare– ekstraktet*

Kosto e shkaktuar deri me datë	80	150	230
Fitimi/(Humbja)	27	(40)	(13)
<b>Minus shumat e faturuara</b>	<b><u>(31.2)</u></b>	<b><u>(134)</u></b>	<b><u>(165.2)</u></b>
<b>Pasuri e kontratës</b>	<b>75.8</b>	<b>-</b>	<b>75.8</b>
<b>Detyrim i kontratës</b>	<b>-</b>	<b>(24)</b>	<b>(24)</b>

4.

(a) Berchtesgaden sh.a zotëron një pronë të blerë në 1 tetor 2019 me kredi për €150 milion. 30% e kostos së blerjes u financua përmes një granti qeveritar. Prona kishte një jetë të dobishme prej 10 vjetësh kur u ble. Berchtesgaden sh.a kontabilizon grantet duke përdorur metodën e të hyrave të shtyera.

**Kërkohet:**

- (i) Trego dallimin ndërmjet grantit të lidhur me pasuri dhe grantit të lidhur me të ardhura. (2 pikë)
- (ii) Përgatiti ekstraktet për pasqyrat financiare të Berchtesgaden sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020, për të reflektuar transaksionet mësipër. (6 pikë)

(b) Amboro sh.a ka aeroplan të cilët i kontabilizon dukë përdorur modelin e kostos sipas SNK 16 Prona, fabrika dhe paisjet dhe e trajton si një pasuri jo-qarkulluese. Kosto dhe të dhënat tjera të një prej aeroplanëve janë dhënë më poshtë:

	<b>Blerë &amp; Shfrytëzuar</b>	<b>Kosto €'000</b>	<b>Jeta e dobishme e vlerësuar</b>
Motori	1 korrik 2018	120,000	48,000 orë fluturimi
Trupi i aeroplanit	1 korrik 2018	250,000	10 vite

Në 1 prill 2020, aeroplani i kompanisë u ul emergjentisht për shkak të motit të keq që çoi në dëmtimin e motorit pa u riparuar. Motori u zëvendësua menjëherë me një të ri me një kosto prej €150 milion me një jetë të dobishme prej 50,000 orë fluturimi.

Në proces, një krah ishte dëmtuar dhe riparuar me një kosto prej €15 milion si dhe ngjyra e jashtme e trupit të aeroplanit u hoq dhe është dashur të të lyhet me një kosto prej €6 milion.

Në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, aeroplani fluturoi për një total prej 1,400 orë prej të cilave 400 orë para 1 prillit 2020 dhe 1,000 orë nga 1 prilli 2020 deri në 31 dhjetor 2020. Në periudhat e mëparshme të kontabilitetit, aeroplani fluturoi për 1,600 orë në vit. Gjithashtu, aeroplani fluturoi 800 orë nga data e blerjes deri me 31 dhjetor 2018. Viti financiar i Amboro sh.a-së përfundon me 31 dhjetor çdo vit.

**Kërkohet:**

- (i) Drejtori financiar i Amboro sh.a ka kërkuar nga ju që të përgatitini ekstraktet e paqyrave financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020, duke përdorur informatat mësipër. (8 pikë)
- (ii) Identifiko dhe shpjego dy indikatorë të dëmtimit të aeroplanit të Amboro sh.a-së. (4 pikë)

(Total: 20 pikë)

#### 4.

##### a)

(i) Grantet e lidhura me pasuritë janë grantet qeveritare, kushti primar i të cilave është që entiteti i kualifikuar për to duhet të blejë, ndërtojë apo në ndonjë mënyrë t'i përvetësojë pasuritë joqarkulluese. Kushte shtesë poashtu mund të jenë të bashkangjitura, duke kufizuar llojin apo lokacionin e pasurive që duhet të blihen apo mbahen. Grantet e lidhura me të ardhura janë Grantet qeveritare të ndryshme nga ato që janë të lidhura me pasuritë.

Ekzistojnë dy zgjidhje se si duhet të paraqiten grantet e lidhura me pasuritë në pasqyrën e pozitës financiare (duke përfshirë edhe grantet jo-monetare me vlerë të drejtë.

(a) Paraqitja e grantit si e ardhur e shtyrë.

(b) Zvogëlimi i grantit për të arritur në shumën bartëse të pasurisë.

Grantet e lidhura me të ardhura janë kredi në pasqyrën e të ardhurave, por ekziston mundësia e zgjedhjes së metodës së shpalosjes.

(a) Prezantimi si një kredi e posaçme ose nën një pjesë të përgjithshme, psh. 'e ardhura tjetër'

(b) Zbritja prej shpenzimeve të lidhura me to

#### ii) Ekstrakt i PFH për vitin e përfunfuar me 31 dhjetor 2020

	€'000
Shpenzimet e zhvlerësimit	15,000
Të ardhurat nga granti	(4,500)

#### Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020

PJQ	
Prona, fabrika dhe paisjet (L11)	131,250
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
E hyra e shtyrë (L12)	34,875
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
E hyra e shtyrë (L12)	4,500

#### L11

Zhvlerësimi i akumuluar  $150 \text{ milion} / 120 \times 15 = 18.75 \text{ milion}$

Vlera bartese neto =  $150 \text{ milion} - 18.75 \text{ milion} = 131.25 \text{ milion}$

#### L1 2

Granti i shtyre =  $131.25 \times 30\% = 39.375 \text{ milion}$

Afatshkurte =  $39.375 \text{ milion} / 105 \times 12 = 4.5 \text{ milion}$

Afatgjate =  $39.375 \text{ milion} - 4.5 \text{ milion} = 34.875 \text{ milion}$

**b)**

(i) Ekstrakt nga Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	<b>€'000</b>
Zhvlerësimi i motorit (1,000+3,000)	4,000
Humbja nga dëmtimi i motorit	113,000
Zhvlerësimi i trupit të aeroplanit	25,000
Kosto e riparimit të krahut	15,000
Lyerja e trupit të aeroplanit	6,000

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2020

PJQ	
PFPP(187,500+147,000)	334,500

ii) indikacionet e dëmtimit nga skenari i Amboro sh.a janë si më poshtë:

- Dëmtimi fizik: kjo ka ndodhur kur ka pasur dëme në motor përtej riparimit.
- Zvogëlimi i performancës ekonomike çdo vit: kjo ndodhi kur orët mesatare të fluturimit u ulën nga 1,600 në 1,400

Llogaritjet

*Vlera bartëse e trupit të aeroplanit*

	<b>€'000</b>
Kosto me 1 korrik 2018	250,000
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2018 (€250,000/10 vite x 6/12)	(12,500)
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2019	(25,000)
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2020	<u>(25,000)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2020	187,500

*Vlera bartëse e motorit*

Kosto me 1 korrik 2018	120,000
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2018 (120,000/48,000 orë x 800 orë)	(2,000)
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2019 (120,000/48,000 x 1,600 orë)	(4,000)
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2020 (120,000/48,000 x 400 orë)	<u>(1,000)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2020	113,000

Kosto e motorit të ri me 1 prill 2020	150,000
Minus zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2020 (150,000/50,000 orë x 1,000 orë)	<u>(3,000)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2020	147,000

5. Huascarán sh.a është një kompani private. Detajet e pasqyrave të saj të pozitës financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë paraqitur më poshtë së bashku me informacione të tjera të rëndësishme.

**Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor:**

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
	€	€
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	4,950	3,822
Prona investuese	700	600
Shpenzimet e zhvillimit	<u>1,740</u>	<u>960</u>
	7,390	5,382
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	2,160	1,362
Të arkëtueshmet tregtare	1,644	1,944
Investimet	858	276
Paraja	<u>174</u>	<u>702</u>
	<u>4,284</u>	<u>4,836</u>
	<b>12,226</b>	<b>9,666</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar – €1 aksione të zakonshme	3,000	2,400
Premia e aksioneve	2,100	600
Teprica e rivlerësimit	912	360
Fitimet e mbajtura	<u>1,522</u>	<u>1,530</u>
	7,534	4,890
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
6% notë krediti	900	600
Detyrimet ndaj lizingut	600	480
Tatimi i shtyrë	<u>288</u>	<u>270</u>
	1,788	1,350
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	1,644	2,112
Detyrimet ndaj lizingut	102	72
Tatimi aktual	336	918
Interesi i notes kreditore	30	-
Mbitërheqja bankare	<u>792</u>	<u>324</u>
	<u>2,904</u>	<u>3,426</u>
	<b>12,226</b>	<b>9,666</b>

**Pasqyra e fitimit ose humjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020**

	€
Të hyrat	8,856
Kosto e shitjeve	<u>(5,772)</u>
Fitimi bruto	3,084
Shpenzimet tjera	(842)
Kosto financiare	<u>(90)</u>
Fitimi para tatimit	2,152
Tatimi në fitim	<u>(972)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>1,180</b>

*Të ardhurat tjera gjithëpërshirëse:*

Përfitimi në rivlerësimin e pronës, fabrikës dhe paisjeve	<u>600</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërshirëse për vitin</b>	<b>1,780</b>

**Shënimet e mëposhtme janë gjithashtu të rëndësishme:**

- i) Gjatë vitit Huascarán sh.a emetoi 1 për 8 aksione bonus, duke kapitalizuar fitimet e mbajtura, dhe me pas emetoi aksione me të drejta.
- ii) Notat e reja të kredisë janë lëshuar në 1 janar 2020. Kostoja e financimit përfshin vetëm interesin e notës së kredisë dhe detyrimet e qirasë.
- iii) Investimet në pasuritë qarkulluese janë obligacione qeveritare të cilat përmbushin përkufizimin e ekuivalentëve të parave.
- iv) Gjatë vitit 2020 zerat e pronës, impianteve dhe pajisjeve me një vlerë bartëse prej €618, ishin shitur për €660. Zhvlerësimi i ngarkuar gjatë vitit për pasuritë afatgjata të prekshme ishte €342. Huascarán sh.a transferon zhvlerësimin shtesë të pasurive afatgjata të prekshme të rivlerësuar në fitimet e pashpërndara siç lejohet nga SNK 16 *Prona, fabrika dhe paisjet*. Zhvlerësimi i bazuar në koston historike në vitin 2020 është €294. E drejta e përdorimit të pasurive në lidhje me lizingjet e reja gjatë vitit arriti në €336. Këto përfshihen në pronën, fabrikën dhe paisjet.
- v) Prona e investimit po matet duke përdorur vlerën e drejtë. Përfitimi i vlerës së drejtë prej €100 për vitin është kredituar në shpenzime të tjera.
- vi) Gjatë vitit 2020, shpenzimet për projektet e zhvillimit arritën në €1,140.

**Kërkohet:**

- (a) **Përgatitni një Pasqyrë të Rrjedhave të Parasë për Huascarán sh.a në përputhje me SNK 7 duke përdorur metodën indirekte.** (15 pikë)
  - (b) **SNK 7 kërkon që transaksionet materiale jo në para të shpalosen në pasqyrat financiare. Jepni shembull të transaksioneve të tilla dhe shpjegoni pse shpalosja është e rëndësishme.** (5 pikë)
- (Total: 20 pikë)**



5.  
a)

**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020**

<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative</i>		€
Fitimi para tatimit		2,152
Korigjimet për:		
Zhvlerësimin		342
Amortizimin (L11)		360
Minus përfitimi nga vlera e drejtë në pronën investuese		(100)
Shenzimet e interesit		90
Fitimi në shitjen e pasurisë (660 - 618)		<u>(42)</u>
		2,802
Rritja në stoqe (L14)		(798)
Zvogëlimi në të arkëtueshmet tregtare (L14)		300
Zvogëlimi në të pagueshmet tregtare (L14)		<u>(468)</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet		1,836
Interesi i paguar (L13)		(60)
Tatimi në fitim i paguar (L13)		<u>(1,536)</u>
<b>Neto paraja nga aktivitetet operative</b>		<b>240</b>
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</i>		
Zhpenzimet e zhvillimit (L11)		(1,140)
Blerja e pronës, fabrikës dhe paisjeve (L11)		(1,152)
Arkëtimet nga shitja e pronës, fabrikës dhe paisjeve		<u>660</u>
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>(1,632)</b>
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve (L12)		1,800
Arkëtimet nga emetimi i obligacioneve		300
Pagesa e detyrimeve ndaj lizngut (L13)		(186)
Dividendat e paguara (L12)		<u>(936)</u>
<b>Neto paraja nga aktivitetet financues</b>		<b>978</b>
Neto zvogëlimi në para dhe ekuivalentë të parasë		(414)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës (L15)		<u>654</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës (L16)		240
<i>Llogaritjet</i>		
<b>1 Pasuritë</b>	<b>Prona, fabrika dhe paisjet</b>	<b>Shpenzimet e zhvillimit</b>
	€	€
S.\fillim	3,822	960
Shitjet	(618)	
F/H	(342)	
TIGJ përfitim nga rivlerësimi	600	
Blerja me lizing	336	
Shtesat (balancuese)		1,140
Amortizimi		<u>(360)</u>
Blerjet me para (balancuese)	<u>1, 152</u>	
<b>S.\fund</b>	<b>4, 950</b>	<b>1, 740</b>

## 2 Ekuiteti

	Kapitali aksionar dhe premia	Teprica e rivlerësimit rivlerësimit	Fitimet e mbajtura
	€	€	€
S.\ fillim	3,000	360	1,530
F/H			1,180
Transferi i zhvlerësimit		(48)*	48*
Përfitimi i rivlerësimit (bal)/TTGJ		600	
Emetimi i obligacionit	300**		(300)**
Emetimi i të drejtave (bal)	1,800		
Dividenda e paguar	-	-	(936)
<b>S.\fund</b>	<b>5,100</b>	<b>912</b>	<b>1,522</b>

\*Ekstra zhvlerësim i transferuar (342 - 294) = €48

\*\* Emetimi i bonus =  $1/8 \times 2,400 = €300$

## 3 Detyrimet

	Obligacionet	Lizingu	Tatimi	Interesi
	€	€	€	€
S.\ fillim	600	552***	1,188****	-
PFHTTGJ			972	90
Lizingu i ri		336		
Paraja e pranuar (paguar) (Bal.)	<u>300</u>	<u>(186)</u>	<u>(1,536)</u>	<u>(60)</u>
<b>S.\fund</b>	<b>900</b>	<b>702</b>	<b>624</b>	<b>30</b>

\*\*\*Detyrimet afatgjate + afatshkurter

\*\*\*\* Detyrimet afatgjate + afatshkurter

## 4 Kapitali qarkullues

	Stoqet	Të arkëtueshmet	Të pagueshmet
	€	€	€
S.\ fillim	1,362	1,944	2,112
Levizjet (Bal.)	<u>798</u>	<u>(300)</u>	<u>(468)</u>
<b>S.\fund</b>	<b>2,160</b>	<b>1,644</b>	<b>1,644</b>

## 5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës

$(276+702-324) = 654$

## 6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës

$(858+174-792) = 240$

### b) Shembuj të transaksioneve pa para mund të përfshijnë

- Konvertimi i borxhit në ekuitet
- Emetimet bonus të aksioneve (kapitalizimi i rezervave)
- Blerja e pasurive afatgjate përmes lizingut ose marrëveshjes së financimit

Shpaloja e transaksioneve materiale pa para do t'u mundësojë përdoruesve të vlerësojnë shkallën në të cilën një kompani mund të paguaj transaksionet e saj pa përdorur para. Kjo do të theksojë për përdoruesit se e tëra nuk varet tërësisht nga paratë e gatshme në pagesen e këtyre transaksioneve. Përdoruesit do të jenë në gjendje të vlerësojnë shkallën në të cilën ata duhet të varen nga informacioni i rrjedhës së parasë në marrjen e vendimeve për likuiditetin dhe fleksibilitetin financiar të kompanisë.